

DEKLARATA

Pavarësia duhet të mbetet e pavarur

Rishikimi i Kulturës Evropjane – udhëzues për 2024

Rishikim!, rrjeti Europjan i nisur nga Arty Farty në Lyon më 2022-in, i bashkon strukturat kulturore të pavarura dhe media që përfaqësojnë diversitetin dhe pluralizmin në Europë dhe amplifikon praninë e tyre e rrjetet e bashkëpunimit nëpërmjet një seri veprimesh.

Qëllimi i rrjetit është të nxjerrë në dukje situatën stresuese dhe nevojat specifike të pavarësisë kulturore të sotme, e cila nuk është as nën kontrollin a ndonjë prej autoriteteve publike dhe as e lidhur me grupet e mëdha private. Duke punuar së bashku për ta rimodeluar (rivendosur) këndvështrimin kulturor e të medias në Europë, ky është edhe qëllimi kryesor i **Reset! (Rivendosje)**, synojmë t'ju paralajmërojmë për rreziqet që sektori ynë po kalon dhe t'ju ofrojmë kontributin tonë për rishkrimin e një manifesti të ri kulturor, social e demokratik.

Europa është në një pikë kthimi. Në një kohë që, kur lufta po rishfaqet në kontinent, forcat shkatërruese, reaksionare dhe autoritare në disa shtete po vijnë në pushtet, duke ushtruar një presion e censurë të pazakontë kundrejt lirisë së fjalës dhe shkëmbimeve kulturore. Aktualisht, pjesëmarrësit e mediave të pavarura e kulturore, tani më shumë se kurrë, janë nën kërcënime të shumta e të ndryshme, nga zhdukja deri tek shtypja dhe marrja nën kontroll, përfshi këtu edhe përqëndrimin e vazhdueshëm të kontrollit ekonomik në sektorit e tyre.

Pavarësisht edhe pse janë dobësuar, megjithatë këto struktura janë të pajisura mirë për t'iu përgjigjur tensioneve që Europa aktualisht po përballlet dhe gjithmonë ato po zhvillojnë mënyra

e teorira të reja që ta drejtojnë drejt rrymës aktuale e komplekse të interesave ekonomike e politike të tyre duke ua kërcënuar kështu fuqinë e dinamikën e tyre.

Edhe një vit deri sa të bëhen zgjedhjet Evropjane, ne, anëtarët e medias dhe e sturkturave të pavarura të **Reset! (Rivendosje), synojmë t'ju paralajmërojmë për rreziqet që sektori ynë po kalon dhe t'ju ofrojmë kontributin tonë për rishkrimin e një manifesti të ri kulturor, social e demokratik.**

Reset! (Rivendosje) i mirëpret të gjithë ata që kanë të njëjtin vizion me ne për një kulturë dhe një fushëgjërësi të mediave të drejta Europiane dhe të kontribojë t'i kthejmë këto ankesa në verpime.

Ne duhet të bëhemi të aftë që të përfitojmë nga mendimet exploruese e të të parit tek e ardhmja e të strukturave të pavarura kulturore, t'u përshtatemi praktikave të brezave të ardhshëm, të përballojmë vështirësitë e kohës sonë: që nga pyetjet ekologjike e deri tek barazia, përfshirja, decentralizimi teknologjik, të drejtat e punësimit, rilidhjet territoriale e edhe më shumë, si edhe mbyllja e boshllëkut midis brezave e politikave kulturore publike.

Është gjithashtu e rëndësishme t'i rezistojmë tendencës së vazhdueshme e përqëndrimit të punës në Europë si në aspektin

kulturore, muzikor, publikues dhe media, i cili, së bashku me komodifikimin (vlerësim për lekë) apo krijimtarinë e artet, përbën një rrezik serioz për egzistencën dhe mbijetesën e kulturës së pavarur edhe të krijimtarisë së lirë, diversitetin artistik, pluralizmin e mendimit dhe, aq më tepër, të rrisi zërat tregues alternativë, nga të dyja anët, kombëtar dhe ndërkombëtar, si brenda dhe jashtë kufinjëve.

Liria mund të jetohej dhe praktikohet vetëm kur ka mënyra të barabarta të përdorimit të materialeve e mundësirave, pavarësi nga ndikimi nga kontrolli i jashtëm, nga ndikimi e detyrime qoftë prej pushtetit autokratik ashtu edhe nga grupet tentuese monopoliste private.

Ne, të pavarurit, formojmë një sistem ekologjik, puna e të cilit është thelbësore për rritjen e çdo iniciative krijuese në territoret që ne përfaqësojmë gjithandej në kontinentin Europjan e përtej. Ne mishërojmë një gjithësi kulturore dhe një media që i ka rrënjët në angazhimin e komuniteteve, me orientimin për të rinjtë e vetëdije shoqërore. Ne besojmë në një vizion dhe të dish-si që është vendimtare për të ardhmen e kulturës sonë. Ne besojmë për bashkëpunim Europjan e ndërkombëtar, në thurjen e marrëdhënieve të ktijuara dhe të qenurit i hapur me të renë, të panjohurën, të ndryshmen dhe tjetrën. Për ne bashkëpunimi dhe shkëmbimet e përbashkëta është kyçi i punës sonë në të ardhmen.

Në 12-të muajt e ardhshëm dhe para zgjedhjeve parlamentare Europjane, ne do

të angazhohemi për të influencuar se si nivelet e politikave publike janë krijuar së bashku në Bashkimin Europjan. Në veçanti, të inkurajojmë zhvendosjen e burimeve financiare në favor të shpërndarjes më të ekuilibruar kundrejt ndihmës urgjente sociale, politike dhe të ambjentit.

Përtej alarmit të ngritur, objektivi i kësaj deklarate është të mbledhë së bashku të gjithë ata që kanë të njëjtën ambicje: të ripërcaktojnë kuptimin thelbësor të pavarësië kulturore, mënyrën se si bashkëveprojnë sektorët dhe mënyrën se si ata lidhen me autoritetet publike e sektorin privat.

Ne kemi një rol tjetër të veçantë për të luajtur në lidhje me ushqimin e qytetarëve rreth një vizioni alternativë të kulturës me pavarësinë në zemër të saj: në krijimin e një ndjenje të një komuniteti në të gjitha iniciativat krijuese: dhe me influencimin e politikave sociale; duke influencuar politikat publike për një mirëkuptim më të gjerë të ndërgjegjes sociale.

Ne besojmë se duke i ngritur zërat tonë si një i vetëm dhe duke filluar të mbështetim këto zgjedhje që tashti, ne mund të ndërtojmë një akt të ri themelues të modelit të ri Europjan për kulturën, median, artet që është i drejtë dhe gjithëpërfshirës, si brenda edhe përtej kufijëve të Europës e gjithashtu edhe për brezat e ardhshëm.

